



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ . _____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)

Data: 23.09.2024

Drejtuar: "SERVIS - AUTO 2000" sh.p.k. me NIPT K31523078F

Adresa: Rruga "Enriko Telini", Nd.15, H.1, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur, e thjeshtuar", Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-15294-08-05-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: LOTI 1 "Riparim dhe mirëmbajtje e mjeteve të Policisë Ushtrake të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura", me fond limit: **2,490,433.33** (dy milion e katër qind e nëntë dhjetë mijë e katër qind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: NR. 47 Datë 12.08.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "Auto Manoku Servis" sh.p.k. me NIPT L62311016C

Vlera e ofruar: 1,618,700 (një milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatë qind) lekë pa TVSH

2. Operatori ekonomik “SERVIS - AUTO 2000” sh.p.k. me NIPT K31523078F

Vlera e ofruar: 1,653,470 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katër qind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH

3. Operatori ekonomik “AEE SERVICE” me NIPT L81530012C

Vlera e ofruar: 1,867,000 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH

4. Operatori ekonomik “Besnik Meçi” me NIPT L12407012R

Vlera e ofruar: 2,073,800 (dymilion e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind) lekë pa TVSH

5. Operatori ekonomik “ALSTEZO” me NIPT J63208420N

Vlera e ofruar: 2,433,000 (dymilion e katër qind e tridhjetë e tre mijë) lekë pa TVSH

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k. me NIPT L62311016C

Përkatësisht për arsyet si më poshtë:

Operatori i klasifikuar në vendim e parë ”Auto Manoku” shpk me NUIS L62311016C në përgjigje të njoftimit për dorëzimin e dokumentacionit ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e ngarkuar në SPE së bashku me dokumentacionin provues të Vetëdeklarimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se për plotësimin e kriteret e veçanta të kualifikimit:

-2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.2 e cila përcakton:

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë të pakten 4 (kater) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.
- b) 1 (një) motorist,
- c) 1 (nje) xhenerikë,
- d) 1 (një) elektroauto.

Në lidhje me punonjësën në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale
- kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Për secilin prej punonjësve në pikat b, c, d, më sipër duhet të paraqitet:
- kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto, bojaxhi dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.
- Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.

OE ka paraqitur për profilin e kërkuar "Motorist", kontratë pune me punonjësën Florenc Gurabardhi të shoqëruar me Dëshmi kualifikimi nga HVAT organizëm Certifikimi dhe për profilin "Elektroauto" kontratë pune me punonjësën Ani Semini të shoqëruar me Dëshmi kualifikimi nga HVAT organizëm Certifikimi.

Certifikatat e mësipërme nuk plotësojnë kërkesën për kualifikim të vendosur nga AK e cila kërkon Dëshmi e aftësisë profesionale, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.

Për sa më lartë OE skualifikohet për mosparaqitje të dokumtacionit të plotë dhe të saktë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "SERVIS - AUTO 2000" sh.p.k. me NIPT K31523078F, me adresë: *Rruga "Enriko Telini", Nd.15, H.1, Tiranë*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,653,470 (*një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katër qind e shtatëdhjetë*) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

TITULLARI I OPERATORIT TË BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA